

ABDURRAHIM MAXHUNI

ÇËSHTJE TË FRAZELOGJISË NË TË FOLMEN E VUSHTRRISË

Abstrakt

Pasuria gjuhësore e shqipes nuk vjen në shprehje vetëm në kuadër të gjuhës standarde shqipe. Dialektet janë pasuri e saj sikurse edhe e çdo gjuhe tjetër. Brenda secilit dialekt ekzistojnë elemente të rëndësishme gjuhësore që e bëjnë të rëndësishëm studimin e tyre. Gegërishtja si dialekt i shqipe ka rëndësi të madhe, brenda saj ka pasuri, që studimi dhe hulumtimi i tyre do ta pasuronte gjuhën shqipe. Frazeologjia e gegërishtes në këtë rast, ajo e së folmes shqipe të Vushtrrisë është vetëm një pjesë e kësaj pasurie. Sikurse çdo e folme edhe ajo e Vushtrrisë në fondin e saj ka mjaft njësi frazeologjike që do të ishin në interes të gjuhësisë studimi i tyre. Frazeologjia si disiplinë në gjuhësi, është një fushë e gjerë dhe e ndërlikuar leksikologjike me probleme të shumta të natyrës teorike e praktike. Në kuadër të këtij punimi do të përpiqemi ta trajtojmë këtë aspekt, duke sjellë në pah pasurinë e saj frazeologjike. Në këtë punim mëtojmë të merremi me pasurinë frazeologjike të së folmes së Vushtrrisë me rrethina.

Fjalët çelës: Frazeologji, dialekt, Vushtri, gegërisht.

Frazeologjia e së folmes së Vushtrrisë

Shprehjet frazeologjike përbëjnë një pasuri të madhe për gjuhën shqipe. Duke pasur një rrugë të gjatë zhvillimi, ato janë tregues i ndjenjave të shumta për çështje të ndryshme jetësore të brezave të tërë, duke përfshirë: jetën, vdekjen, punën, urrejtjen, dashurinë, përtacinë, pleqërinë, e fusha të tjera që janë pjesë e jetës e shpirtit të njeriut. Frazeologjia përbën grupin më të rëndësishëm në tërësinë e mjeteve shprehëse me vlerë emocionuese e stilistike në gjuhën shqipe. Dialektet dhe të folmet e ndryshme mbesin burim i përherëshëm krijues dhe njëkohësisht pasurues i fondit frazeologjik të shqipes. Ndërmjet ligjërimeve e stileve të gjuhës letrare shqipe ka ndryshime nga mënyra e përvetësimit të njësive frazeologjike të gjuhës së folur, nga mënyra e krijimit të njësive frazeologjike të reja sipas gjedheve popullore, nga mjetet dhe tipat strukturorë që pasurojnë fondin e frazeologjisë në përputhje me kërkesat e ligjërimit e të stilit¹.

Fjalët veç e veç nuk mund t'u shërbejnë njerëzve për t'u marrë vesh ndërmjet tyre. Ato kanë vetinë të lidhen njëra me tjetrën sipas ligjeve të gjuhës, sipas rregullave të gramatikës dhe ashtu së bashku formojnë njësi

¹ Jani Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, 1981, f. 53.

gjuhësore më të larta, togfjalësh a fjali, të cilat përdoren gjatë ligjëritimit. Në këtë kuadër kemi togfjalësh të lirë, të cilët krijohen aty për aty gjatë ligjëritimit, si: *shtin dru* (në stufë) dhe togfjalësh të qëndrueshëm, të cilët nuk formohen aty për aty, por janë formuar historikisht dhe përdoren si njësi të gatshme, si: *shkel e shko, t'furat hundi, i hunit e i konopit* etj.

E folmja e Vushtrrisë është mjaft e pasur me shprehje frazeologjike, të cilat janë ruajtur nga brezat e vjetër. Njëkohësisht edhe gjenerata e re është duke i përdorur këto njësi të trashëguara, duke i përdorur këto njësi si pjesë të fjalorit të tyre të përditshëm. Treva për të cilën është bërë studimi, në krahasim me hapësirën shqiptare mund të jetë edhe e vogël, me rreth 67 fshatra, megjithatë kjo është pjesë e rëndësishme në tërësinë frazeologjike mbarë shqiptare.

Klasifikimi i njësive frazeologjike

Gjuhësia shqiptare klasifikimin e njësive frazeologjike e ka klasifikuar në bazë të strukturës, nga vlera leksiko-gramatikore dhe nga shkalla e motivimit. Natyrisht se ky klasifikim vlen edhe për njësitë frazeologjike të së folmes së Vushtrrisë.

Njësitë frazeologjike me vlerë emërore

Në klasifikimin e frazeologjisë sipas kuptimit leksiko-gramatikor bëjnë pjesë njësitë frazeologjike me vlerë emërore. Në krahasim me njësitë e tjera, ky grup në të folmen e Vushtrrisë nuk është aq i larmishëm dhe nuk paraqitet me numër të madh. Pra ky grup ka vlerë emërore dhe njësitë funksionojnë si emra. Në këtë grup përfshihen disa lloje:

1. Njësi frazeologjike të ndërtuara me gjymtyrë emërore (emër + emër). Nga kuptimi këto njësi frazeologjike kanë vlerë emërore, sepse shënojnë njerëz, kafshë, sende, dukuri e veprime të substancializuara, nëpërmjet emërtimit të figurshëm. Për këtë arsye kanë ngjyrim emocional të theksuar. *Axhami u plak*, njeri që është i papjekur.

therrë me bisht, kur një punë nuk i del ashtu siç ka menduar lehtë

kodra mas bregut, kur dikush fol pa lidhje. Mos qit kodra mas bregu

fjalë t'kafes, fjalë që nuk ia vlen t'u kushtohet vëmendje, se nuk kanë vlerë dhe nuk janë të sakta *bira t'gardhit*, shprehje që për të treguar se nuk ke mundësi çdo nevojë ta plotësosh. Birat e gardhit nuk mshelen kurrë.

kaprrrec plak, njeri i shtyrë në moshë, por që nuk është burrë i mirë.

qyk boshnjaku, shprehje që përdoret kryesisht për gra, të cilat janë të pakuptueshme. Kjo është qyk boshnjaku, s'ja len fjala.

baksuz njeri, që nuk i shkojnë punët mirë, madje ua prish punën edhe të tjerëve.

njeri pa marre, njeri që bën çka të dojë e nuk skuqet, nuk ka marre.

2. Disa terma të fushës së bimësisë, të kafshëve, të gjeografisë, të astronomisë, të historisë etj., që ndërtohen me emra e mbiemra dhe që i shënojnë sendet nëpërmjet një emërtimi tjetër, në mënyrë të figurshme, si:

qyqja natës (njeri i mbetur si qyqe, keq), *pulë e nukt* (njeri i bërë si mos më keq)

Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore

Edhe njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore përbëjnë një grup të veçantë në klasifikimin e frazeologjisë së të folmes së Vushtrisë sipas kuptimit leksiko-gramatikor. Është një grup më i vogël se ai emëror dhe më pak i larmishëm nga ndërtimi.

Njësitë frazeologjike mbiemërore kanë kuptimin e përgjithshëm të kategorisë së mbiemrit, kanë vlerë mbiemërore dhe funksionojnë në ligjërimi si mbiemra. Ata kanë përgjithësisht kuptimin e mbiemrit predikativ e jo të atij atributiv.²

1. Njësitë frazeologjike që përbëhen nga dy gjymtyrë emërore. Nga marrëdhëniet këto gjymtyrë janë me lidhje këpujore ose me lidhje përcaktore. Këto njësi frazeologjike janë formuar duke u mbështetur në një krahasim dhe shënojnë zakonisht shkallë të lartë cilësie³, si: *i hunit e i konopit*, dikush që nuk le të zezë pa bërë dhe është shumë problematik.

asht e lkur, njeri i dobët nga shëndeti. *Ish bo asht e lkur*. etj.

2. Njësi frazeologjike që fillojnë me lidhëzën ‘si’. Ndërtime të tilla mund të merren edhe si krahasime të thjeshta. Këto njësi janë ndërtime që japin një shkallë të lartë cilësie. P.sh.: *si pula pa kry*, *si lopë e cekraft*, *si peshku n’zall*, *si pulë e nukt* etj.

3. Njësi frazeologjike që nisin me parafjalën ‘me’. Sipas Thomait këto njësi frazeologjike janë të tipit pronësor. Struktura e këtyre njësive duhet lidhur me foljen *kam*, p.sh.: *me men nkry*, e nxoni *me pelë për dore*, met mashtru *me pare n’dorë* etj.

4. Njësi frazeologjike që vijnë prej tipit foljor dhe që në vend të gjymtyrës foljore kanë një mbiemër prejpjesor, si: *njeri i regjur*, *i bon lomsh*, *i bon llom*, *i bon kahre* etj.

Njësitë frazeologjike me vlerë foljore

Njësitë frazeologjike foljore kanë kuptimin kategorial të foljes dhe funksionojnë në ligjërim si folje. Sikurse në mbarë shqipen ashtu edhe në zonën e Vushtrisë, ato përbëjnë tipin më të pasur frazeologjik.

Tek njësitë frazeologjike foljore njëra gjymtyrë domosdo është folje dhe kjo gjymtyrë në gjuhën shqipe zakonisht është e para.

shet men njeri që filozofon shumë, ndërsa punët nuk i ka askund”

hëngri dajak, *çon kry*, *bon be*, *ngul kom*, *hiq dorë*, *qet bishta*

rras hunt, *prishi ftyrën*, *lag gojën*

Frazeologjia e gjuhës shqipe është parë si krijim kryesisht popullor e historik që bart tregues të psikologjisë e të mendësisë, të historisë e të kulturës

² Po aty, f. 84.

³ Po aty.

së shqiptarëve. Studiuesi Thomaji kur flet për vlerat e njësisë frazeologjike shprehet: “ajo sjell pasurim e zgjerim të mjeteve të shprehjes, por edhe vlera më të mëdha në përmbajtje e në ngjyrimin emocionues, sjell nuanca të holla kuptimesh e përdorimesh, gjykimin e popullit për gjërat e për njerëzit⁴. Burimet e krijimit të njësive frazeologjike janë të ndryshme. Ato janë me burim vendës, por mund të kenë hyrë edhe nga një gjuhë tjetër. Karakteri popullor i frazeologjisë së shqipes duket edhe në gjymtyrët përbërëse të njësive frazeologjike. Shumë njësi frazeologjike ndërtohen me fjalë që shënojnë pjesë të trupit, si: dorë, faqe, këmbë, krah, lëkurë, sy, shpinë, vesh, me fjalë që shënojnë sende, të cilat e rrethojnë njeriun: derë, lugë, prag etj, me fjalë që shënojnë bimë e kafshë: dhi, gomar, gjel, lule, mushkë, qen, me foljet më të zakonshme, si: bëj, dal, hyj, kam, kap, shkoj, shoh etj.

Nëse e marrim fjalën krah, do të shohim se ajo është e lidhur me punën, përkrahjen, mburrjen etj. Në çdo moment populli ka krijuar fjalë a njësi për t’u shprehur sa më mirë.

Ju than kraht të shkretit. Nuk i ndihmuan, nuk i dhanë ndihmë, nuk i dhanë krah.

Nuk ka krah. Shprehje që përdoret për të treguar se dikush është i vetëm e nuk ka përkrahje. A veç qi e ke gjet pa krah pe nguc a?

E ka krahun e fort. Shprehje që përdoret për të treguar se dikush është i fortë me ndihmën e të tjerëve. Ky e ka krahun e fort se moti ish harru.

Mos i ço kraht. Shprehje që përdoret për të treguar se dikush mburret për ndonjë punë të kryer, ose krekoset për shkak se ka dikë me pozitë të lartë në familje.

E nxjerr bukën me krah. Shprehje që përdoret për të treguar se dikush fiton duke punuar si punëtori krahu.

Ka marrë krah. Shprehje që përdoret për të treguar se dikush ka marrë përkrahje nga ndonjë njeri i lartë me pozitë, ose nga familja e tij.

Koke qu n’krah t’shmajt. Shprehje që përdoret për të treguar se dikush është ngritur i inatosur e jo në gjendje të mirë, ose i shkojnë punët keq gjatë ditës.

Prania e orientalizmeve në frazeologjinë e Vushtrrisë

Si shumica e të folmeve as e folmja e Vushtrrisë nuk i ka shpëtuar pranisë së madhe të orientalizmeve, qoftë në leksik, qoftë në frazeologji. Nëse e kemi parasysh praninë disa shekujsh të osmanëve në trojet shqiptare, atëherë është shumë normale që të kemi një ndikim të madh të fjalëve dhe shprehjeve orientale, konkretisht të turqizmeve, persizmeve dhe arabizmeve.

Në Vushtrri prezenca e osmanëve së pari shënohet në vitin 1439, ndërsa definitivisht u pushtua më 1455. Vendosja e administratës osmane në Vushtrri, bëri që në këtë qytet të përhapet feja islame, dhe të ndërtohen xhami, hane,

⁴ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 238.

medrese, hamame (banjo publike) etj. Me përhapjen e Islamit, ndikimi në gjuhën shqipe ishte i madh. Natyrisht se tashmë banorët kishin të bënin me një terminologji të re, qoftë fetare, administrative e ushtarake. Gjatë sistemimit të materialit të mbledhur në trevën e Vushtrisë kemi hasur në qindra njësi frazeologjike që kanë si gjymtyrë një fjalë turke, perse a arabe, si p.sh.: *ka bo vaki, ishalla n'xhenet, ishalla me imon, selam t'shpisë, paç ymer, kudreti i Zotit etj.*

Frazeologjia e sferës fetare me njësi frazeologjike që kanë si gjymtyrë një fjalë turke, perse a arabe është shumë e shtrirë në rrafshin e folur. Duke e ditur se banorët e Vushtrisë njihen si praktikues të fesë islame, përdorimi i këtyre njësive frazeologjike është i madh, p.sh.

Allahu kabull, shprehje që përdoret për falësit e namazit, apo agjëruesit e muajit të shenjtë të Ramazanit.

Prania e fjalëve turke, arabe dhe perse, në njësi frazeologjike nuk është karakteristikë vetëm e të folmes së Vushtrisë. Mund të themi se kjo është një karakteristikë e mbarë shqipes, sepse e gjejmë gjithandej në shqipen e folur.

Ishalla me imon, shprehje që përdoret për t'u lutur për të vdekurin me rastin e shkuarjes për ta ngushëlluar familjen e të vdekurit.

Përfundim

Njësitë frazeologjike të trajtuara mund të shfaqen edhe në treva të tjera, megjithatë secila trevë ka karakteristika e veta, që përfshaqet me disa ndryshime dialektore, me ngjyime, nuance e variante fonetike e kuptimore. Mendojmë se studimi i këtyre njësive do të ishte një kontribut në vazhden e studimeve frazeologjike mbarë shqiptare, duke sjellë karakteristikat e veçante shprehëse të mendësisë së popullatës.

BIBLIOGRAFI

Androkli Kostallari, *Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII*, "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe" III, Tiranë, 1989.

Jani Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, 1981.

Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

Zenun Gjocaj, *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë, 2001.

